



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:067490

Datë: 10.08.2023

Numri i dokumentit: 04571585

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurve F.H., me vendbanim në Ferizaj rruga “...” dhe S.Sh., me vendbanim në Ferizaj rruga “...”, duke vendosur lidhur me marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND. 109/2023, të datës 08.08.2023, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurve F.H. dhe S.Sh. në njëri anë dhe të dëmtuarit A.N., në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.335/2023, të datës 15.03.2023, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK), në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (tani e tutje KPP) dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance, më datë 10.08.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr.109/2023, e datës 08.08.2023, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurve F.H., me vendbanim në Ferizaj rruga “...”, i lindur me datë ..., me numër personal ..., shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe të pandehurit S.Sh. me vendbanim në Ferizaj rruga “...” i lindur më ..., me numër personal ..., shtetas i Republikës së Shqipërisë, në njëri anë dhe të dëmtuarit A.N., me vendbanim në Ferizaj rruga “...”, në anën tjetër.
- II. Hudhet** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 335/2023, e datës 15.03.2023, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurve F.H. me numër personal ..., shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe S.Sh., me numër personal ..., shtetas i Republikës së Shqipërisë, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

III. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr. 335/2023, të datës 15.03.2023, i ka akuzuar të pandehurit F.H., me vendbanim në Ferizaj rruga “...” dhe S.Sh., me vendbanim në Ferizaj rruga “...”, lidhur me veprën penale në bashkëkryerje Vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Më datë 27.07.2023, është mbajtur shqyrtimi fillestar dhe në këtë shqyrtim fillestar bazuar në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim palët kanë propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet përmes procedurës së ndërmjetësimit. Gjykata e ka aprovuar propozimin e palëve dhe bazuar në nenin 229 paragrafi 1 të KPP-së, e ka referuar çështjen në ndërmjetësim.

Më datë 08.08.2023 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr. 109/2023, në mes të të pandehurve F.H., me vendbanim në Ferizaj rruga “...”, i lindur me datë ..., me numër personal ..., shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe të pandehurit S.Sh. me vendbanim në Ferizaj rruga “...” i lindur më ..., me numër personal ..., shtetas i Republikës së Shqipërisë, në njërën anë dhe të dëmtuarit A.N., me vendbanim në Ferizaj rruga “...”, në anën tjetër.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim KPP-në dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, dhe kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga të gjitha të lartcekurat, e në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2023:067491, datë 10.08.2023

Zyrtarja ligjore,

Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.